



Më
Dana

07-06-2018

P.nr.2048/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtari Adem Shabani, me zyrtarin ligjor Blend Rexhepi, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED], nga Shtime, rruga " [REDACTED] ", pn, i akuzuar nga Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzë PP.II.nr.1176-7/2017, e dt. 17.08.2017, për shkak të veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prani të përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, të akuzuarit [REDACTED] dhe përfaqësuesit të Komunës Shtime, [REDACTED], me datën 11.01.2018 të njëjtën ditë mori dhe publikoi këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari [REDACTED] nga Shtime, rruga " [REDACTED] ", pn, i lindur me datë [REDACTED], me vendbanim në Shtime, nga i ati [REDACTED], e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i martuar, babë i një fëmije, i gjendjes së varfër ekonomike, i pa dënuar deri me tani, me numër personal [REDACTED] mbrohet në liri,-

ËSHTË FAJTORË

Sepse me datën 14 Qershor 2017, në Shtime, në mënyrë të kundërligjshme ka uzurpuar pronën publike në sipërfaqe prej 3 ari, me kulture bujqësore, kullose e klasës 4, parcela numër P-72809093-00016-1, zona kadastrale Shtime, prone shoqërore e pyjeve, në atë mënyrë që në pronën e uzurpuar ka ndërtuar shtëpi të cilën e shfrytëzon për nevoja të tij të banimit, duke e mbajtur kështu pa ndonjë baze juridike,

-Me të cilën kreu veprën penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të KPRK-së të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitës sipërcituar dhe nen. 4,7,41,42,43,49,50,51 dhe 73 të KPRK-së si dhe nen. 365 të KPPK-së e

G J Y K O N
M E D Ë N I M M E K U S H T

Të akuzuarit [REDAKTUAR] i shqipton dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3/ tre/ muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej një /1/ vite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohet i akuzuari, që të dëmtuarës Komunës së Shtimes, në afat prej 6 /gjashtë/ muajve, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi ta lirojë pronën uzurpimin e paligjshëm të pronës publike ne sipërfaqe prej 3 /tre/ ari, parcela numër P-72809093-00016-1, zona Kadastrale Shtime, pronë shoqërore e pyjeve.

Ne qoftë se i akuzuari nuk e liron uzurpimin e pronës së paligjshme ne afatin e dhenë nga gjykata pas kalimit të afatit do të ekzekutohet ne mënyrë te dhunshme

Komuna Shtime, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, ka të drejtë që ta ekzekutojë lirimimin e pronës së uzurpuar nëse në mënyrë vullnetare nuk është liruar prona nga i akuzuari.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Komuna Shtime, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ka të drejtë që ta ekzekutojë lirimin e pronës së uzurpuar nëse në mënyrë vullnetare nuk është liruar prona nga i akuzuari.

Në bazë të nen. 450 par.2 nënpar 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së gjykata të akuzuarin e obligoi që të paguaj shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.2048/2017 datë 11.01.2018

Zyrtar Ligjor
Blend Rexhepi

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.